



NË KËTË NUMËR:

<i>Diplomoi gjenerata e re e studentëve të "Pjetër Budit"</i>	2
<i>Kolegji "Pjetër Budi" edhe me një program të ri - Juridik LLB</i>	5
<i>Në Kolegjin "Pjetër Budi" u organizua Dita e Hapur</i>	6
<i>Studentët e Kolegjit "Pjetër Budi" ndihmojnë personat me sindromin Down</i>	7
<i>Studentët përfunduan praktikën në Doganë</i>	8
<i>"Real Madrid" fitues i turneut të futbollit</i>	10
<i>dhe të tjera...</i>	

Diplomoi gjenerata e re e studentëve të “Pjetër Budit”

Gjenerata e re e studentëve të Kolegjit “Pjetër Budi” ka diplomuar në një ceremoni solemne të organizuar në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Studentët e diplomuar kanë përfunduar studimet në nivelet Bachelor e Master, në programet Doganë dhe Shpeditcion, Administrim Biznesi, Menaxhim i Turizmit e Hotelerisë, Sigurime dhe Menaxhim i Sigurimeve.

Dekani i “Pjetër Budit”, Nuhi Rexhepi, në fjalimin e tij tha se gjatë studimeve në auditorët e këtij kolegji është skalitur portreti i doganierit, i punonjësit të sigurimeve, i specialistit të turizmit, portreti i biznesmenit të suksesshëm, që kanë krijuar një shumësi vlerash.

“Emri i nderuar i kolegjit, përbërja e profesoratit si dhe afirmimi i atyre që kanë diplomuar në vitet e mëparshme dhe tani, ngjallin shpresë, besim e respekt, ata nuk u zhgënjyen sikundër nuk do të zhgënjeheni ju dhe ata që do të vinë pas jush, sepse shpirti i juaj krijues përherë ka gjeneruar dije e kulturë. Ajo që e shquan këtë brez pas tre vjetësh pune, është se ne shohim një bilanc solid tuajin dhe të këtij institucioni të rëndësishëm – ju mirëpresim në studimet pasuniversitare”, theksoi Rexhepi. Sipas tij, “Pjetër Budi” në vijimësi do të tregojë qëndrueshmëri dhe ruan rezerva për të ushtruar rolin e vet për të rrezatuar informacion shkencor, arsimor e kulturor, për të riformuluar vlerësimet në kushtet e një sistemi të hapur demokratik.





I ftuari në këtë ceremoni, shkrimtari dhe ligjëruesi i Artit të Mendimit Pozitiv, Daut Demaku, porositi studentët që të jenë të guximshëm në çdo hap që marrin në jetë, ndërkaq për dështimet të mos i fajësojnë të tjerët asnjëherë, por fajin ta kërkojnë te vetja. Përfaqësuesi i Organizatës Studentore, Frashër Kastrati, iu është drejtuar studentëve nëpërmjet një videomesazhi nga SHBA-ja, ndërkaq ceremonia është shoqëruar edhe me pika artistike të interpretuara nga vijuesit e shkollës për kitarë “Vihuela”.

Ky vit akademik ishte i nënti me radhë i funksionimit të Kolegjit “Pjetër Budi”, i cili shquhet për ofrimin e studimeve universitare në programe akademike zhvillimore.



Ju i keni dhënë jetë dhe emër të nderuar “Pjetër Budit”

Kolegji “Pjetër Budi”, megjithëse për nga mosha i ri, është institucion me shumë interes që, po ndërton një traditë të shkëlqyer në fushë të Doganave dhe Shpëdicionit, Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelierisë, Administrim Biznesit dhe Sigurimeve, është një institucion i nderuar, i dashur për të gjithë, veçanërisht mikpritës për të rinjtë dhe të rejtat e vendit.

Për këto tri vite, në auditorët e Kolegjit “Pjetër Budi” është skalitur portreti i doganierit, i punonjësit të sigurimeve, i specialistit të turizmit, portreti i biznesmenit të suksesshëm, që kanë krijuar një shumësi vlerash.

Brezi juaj nga viti në vit ka shënuar përparim duke lëvizur drejt së ardhmes, duke synuar horizonte e lartësi të reja në fushë të dijes për të mbështetur të ardhmen, duke u bërë shtysë i rëndësishëm për kultivimin e vlerave fillestare të studiuesve të rinj, që do të bëjnë emër në fushat e studimit që ndjekin. Rezultatet e punës suaj janë barometri që matë vlerat e padiskutueshme dhe që mund të japë alternativa të reja për të ardhmen, sepse universiteti prodhon, shqyrton dhe shndërron kulturë nëpërmjet punës studimore, mësimdhënies dhe mësimnxënies.





Gjatë gjithë këtyre viteve jemi përpjekur t'ju krijojmë kushte sa më të mira pune në planin studimor, kemi trajtuar me ndjeshmërinë më të madhe shqetësimet e tuaja dhe kemi vepruar për zgjidhjen e tyre, jemi përpjekur t'ju ofrojmë shërbime lehtësuese për të ngritur nivelin arsimor, shkencor e kulturor, kemi organizuar aktivitete që plotësojnë argëtimin në format e tij më të larmishme, me një fjalë, institucioni ynë ju ka siguruar juve, studentëve të këtij brezi realizim normal në rrafshin profesional, intelektual, personal e shoqëror.

Emri i nderuar i Kolegjit, përbërja e profesoratit si dhe afirmimi i atyre që kanë diplomuar në vitet e mëparshme dhe tani, ngjallin shpresë, besim e respekt, ata nuk u zhgënjyen sikundër nuk do të zhgënjeheni ju dhe ata që do të vijnë pas jush, sepse shpirti i juaj krijues përherë ka gjeneruar dije e kulturë. Ajo që e shquan këtë brez pas tre vjetësh pune, është se ne shohim një bilanc solid tuajin dhe të këtij institucioni të rëndësishëm – ju mirëpresim në studimet pasuniversitare. Kolegji “Pjetër Budi” në vijimësi do të tregojë qëndrueshmëri dhe ruan rezerva për të ushtruar rolin e vet për të rrezatuar informacion shkencor, arsimor e kulturor, për të riformuluar vlerësimet në kushtet e një sistemi të hapur demokratik.. Për tre vjet pune e studimi në këtë Kolegj, i keni dhënë jetë dhe emër të nderuar institucionit ku keni studiuar – për të gjitha këto ju falënderojmë!

(Thekse nga fjalimi i Dekanit të Kolegjit “Pjetër Budi”, Prof. Dr. Nuhi Rexhepi, mbajtur në ceremoninë e diplomimit të studentëve)

Kolegji “Pjetër Budi” edhe me një program të ri - Juridik LLB

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga këshilli i ekspertëve të jashtëm, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka marrë vendim për akreditimin e Programit Studimor Juridik të Kolegjit “Pjetër Budi”.

Programi LLB Juridik në Kolegjin “Pjetër Budi” paraqitet si nismë që të edukojë liderët e rinj akademikë në lëmin e shkencave të drejtësisë. Të diplomuarit nga ky program do të arrijnë një shkallë të avancuar të njohurive në fushat e tyre të zgjedhura dhe do të fitojnë shkathtësi origjinale akademike dhe shkencore.



Programi është i strukturuar nga një përbërje e mirëfilltë interdisiplinare, lëndë të domosdoshme, zgjedhore, punë kërkimore dhe ngritje të kapaciteteve publike.

Në Kolegjin “Pjetër Budi” u organizua Dita e Hapur

Në Kolegjin “Pjetër Budi” është organizuar manifestimi Dita e Hapur, për të shënuar 15 vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe në shenjë mirënjohjeje ndaj sakrificës së gjithë atyre që kontribuan për lirinë.

Gjatë gjithë ditës, në kolegji janë organizuar aktivitete të ndryshme edukative e argëtuese, me qëllim të shoqërimit të studentëve, profesorëve dhe mysafirëve të tjerë, si dhe qytetarëve që kanë shprehur dëshirën të vizitojnë “Pjetër Budin”.

Pjesë e festës kanë qenë edhe nxënës të shkollave fillore, të cilët të shoqëruar nga pedagogët e tyre kanë vizituar kolegjin dhe janë njohur me punën e tij.

Aktivitetet edukative e argëtuese janë shoqëruar edhe me ushqime tradicionale, me qëllim të promovimit të tyre, ndërkaq studentët kanë organizuar edhe një aksion humanitar për shitjen e produkteve me logon e “Pjetër Budit”. Mjetet financiare të mbledhura nga ky aksion janë dedikuar për shoqatën Down Syndrome Kosova.





Studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” ndihmojnë personat me sindromin Down

Një aksion humanitar është organizuar nga studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” në Ditën e Hapur të këtij institucioni.

Paratë e mbledhura nga shitja e produkteve të ndryshme me logon e “Pjetër Budit” i janë dedikuar shoqatës Down Syndrome Kosova. Në Ditën e Hapur, pjesë e aktiviteteve kanë qenë edhe pjesëtarë të komunitetit me sindromin Down, të cilët janë shoqëruar me student, profesorë dhe të jerrë të pranishëm dhe kanë kontribuar në programin e paraparë.

Ky është aksioni i dytë humanitar i studentëve të “Pjetër Budit” pas atij të dhurimit vullnetar të gjakut.



Studentët përfunduan praktikën në Doganë

Studentët e vitit të dytë të drejtimit Doganë dhe Shpedicion, të Kolegjit “Pjetër Budi” e kanë përfunduar punën praktike në disa pika doganore të Republikës së Kosovës.

Njëri nga studentët, Arbër Dakaj, tha se praktika në Doganë është mundësi mjaft e mirë që t’i testojnë njohuritë e fituara gjatë ligjëratave.

“Gjatë praktikës në Doganë jemi duke përfituar njohuri të shumta, të cilat na janë prezantuar gjatë ligjëratave, por këtu po kemi mundësi t’i shohim dhe t’i praktikojmë, psh. njohuritë e depos, kontrollimi i kontenjerëve, verifikimi i mallit ejt”, theksoi Dakaj.

Praktika në pikat doganore është e obligueshme për çdo student, ndërkohë që studentët e drejtimeve të tjera - Sigurime, Menazhim i Turizmit dhe Hotelorisë dhe Administrim Biznesi po ashtu e kanë të obligueshme kryerjen e praktikës në kompani sigurimi, kompani hotelere dhe turistike dhe biznese të ndryshme.





U promovua libri i Ulpiana Lamës “Ia dolëm!”



Në Kolegjin “Pjetër Budi” është promovuar libri i autores Ulpiana Lamës “Ia dolëm!”, një homazh për Kosovën në 15 vjetorin e çlirimit. Libri është përmbledhje e artikujve publicistikë të botuar ndër vite nga autorja në shtypin e Kosovës dhe të Shqipërisë.

Me sponsorizimin e Kolegjit “Pjetër Budi”, libri është botuar nga shtëpisë botuese “Saras”. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin edhe personalitete të artit, kulturës, medias, institucioneve etj.

U mbajt faza e dytë e trajnimeve për testin e maturës

Në Kolegjin “Pjetër Budi” është mbajtur faza e dytë e trajnimeve për Testin e Maturës, për të gjithë të interesuarit.

Trajnimet e kësaj faze janë organizuar në lëndët profesionale, si Ekonomi-Ndërmarrësi, Juridik dhe Edukatë Qytetare.



“Real Madrid” fitues i turneut të futbollit

Ekipi “Real Madrid” i përbërë nga Ardit Ajeti, Atdhe Muriqi, Pajtim Shaqiri, Kadri Durguti, Dardan Topalli dhe Fisnik Topalli është fitues i turneut në futboll të Kolegjit “Pjetër Budi”, që u organizua në Prishtinë.

Me pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit të kolegjit, turneu u organizua në kuadër të manifestimit Ditët e Hapura të “Pjetër Budit”.

Në finale, “Real Madrid” me rezultat 4:2 mposhti ekipin “Indianët” të përbërë nga Arbër Dakaj, Arbër Mazreku, Emrush Avdyli, Besim Sejdia, Besart Samadraxha dhe Mentor Isufi. Për studentët e ekipit fitues u ndanë mirënjohje.





Dhurojnë gjak, shpëtojnë jetë!

Në Kolegjin “Pjetër Budi” është organizuar aksioni tradicional i dhurimit vullnetar të gjakut, nga ana e studentëve dhe stafit të kolegjit. Aksioni i ka paraprirë Ditës Botërore të Dhurimit Vullnetar të Gjakut. Dhurimi i gjakut është shumë i rëndësishëm për ata që kanë nevojë, mirëpo sipas një studimi të bërë së fundi është parë se edhe donatori përfiton në aspektin shëndetësor. Sipas një studimi të bërë me 2682 meshkuj nga Finlanda, të cilët kanë dhuruar gjak rregullisht, 88 për qind e tyre kanë pasur më pak rrezik nga sulmet në zemër, në krahasim me ata që nuk dhurojnë gjak.

Aksioni tradicional i dhurimit vullnetar të gjakut, nga ana e studentëve dhe stafit të Kolegjit “Pjetër Budi” është pjesë e aktiviteteve që organizohen në kuadër të manifestimit Ditët e Hapura të “Pjetër Budit”.





KOLEGJI PJETËR BUDI PRISHTINË

KARRIERA JUAJ FILLON KËTU !

KONKURS

Për regjistrimin e studentëve në vitin akademik 2014 - 2015

BACHELOR

- Doganë & Shpedicion
- Juridik
- Menaxhim i Turizmit & Hotelerisë
- Administrim Biznesi
- Menaxhim i Resurseve Njerëzore
- Administratë Publike
- Menaxhim i Marketingut
- Banka – Kontroll Financiar (Polici Financiare)
- Sigurime

MASTER

- Doganë & Shpedicion
- Menaxhment
- Menaxhim i Sigurimeve
- Menaxhim i Turizmit & Hotelerisë

Afati i parë i regjistrimit
fillon më 7 korrik dhe përfundon
më 7 gusht 2014

APLIKO

Shfrytëzo kushtet e volitshme
Pagesë në 12 këste dhe lehtësira të tjera

ZBRITJE

- Nxënës të shkëlqyeshëm - 10% (BA)
- Grupe deri në 5 veta - 5% (BA & MA)
- Grupe deri në 10 veta - 10% (BA & MA)
- Dy pjestarë të një familje - 50% (BA & MA)
- Pjestarët e PTK-së - 30% (BA & MA)
- Pjestarët e PK-së / Polici Financiare - 30% (BA & MA)
- Pjestarët e FSK-së - 20% (BA & MA)
- Dogana e Kosovës/Shpedicionet - 20% (BA & MA)
- Studentët e Pjetër Budit - deri 10% (MA)

Studime të rregullta universitare
Studime pa shkëputje nga puna
Studime me korrespondencë

Dokumentet e nevojshme për regjistrim

- Diploma e shkollës së mesme
- Dëftesat e secilit vit të shkollës së mesme
- Çertifikata e lindjes
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Dy fotografi

Adresa:

Ish objekti i Ombudspersonit përballë Mensës së Studentëve
Ulplanë, Prishtinë
Tel: +381 38 234 566 / +377 44 163 372 / +386 49 163 372
E-mail: pjeterbudi@gmail.com
www.pjeterbudi.com

Marrveshja me institucione prestigjioze vendore e ndërkombëtare:



Studentët me notë mesatare mbi 9.3 përfshihen në "listën e ngushtë" me rastin e rekrutimit të stafit në Doganën e Kosovës.